



Australian Government

Department of Health

Mësime për Australinë nga rritja e rasteve me COVID-19 në Melburn

Rritja e numrit të rasteve me COVID-19 kohët e fundit në zonat e Melburnit është zhgënjyese, por ne gjithmonë prisnim më shumë raste. Është e rëndësishme që i gjithë vendi mos ta harrojë këtë.

Është e domosdoshme që të nxjerrim mësimet nga kjo rritje e numrit të rasteve ose ndryshe rrezikojmë të shohim shumë më tepër në të gjithë Australinë, duke vënë në rrezik pjesën më të madhe të asaj që kemi punuar kaq shumë për të arritur në luftën tonë kundër COVID-19.

Një mesazh i rëndësishëm që do të doja të theksoja është se, me gjithë suksesin tonë në luftimin e COVID-19, nuk jemi në një fazë ku mund të kthehemi të bëjmë jetën tonë ashtu si kemi bërë përpara se Australia të kishte pandeminë. Virusi është ende me ne, dhe do të jetë për ca kohë - dhe situata ndërkombëtare vazhdon të përkeqësohet e jo të përmirësohet.

Rritja e rasteve në Viktoria tregon se sa e lehtë është të ndodhin shpërthimet, nëse nuk vazhdojmë të praktikojmë distancën e duhur fizike dhe higjienën e duhur dhe të qëndrojmë në shtëpi kur jemi të sëmurë. Kjo gjithashtu na kujton për rëndësinë e shkarkimit të aplikacionit COVIDSafe, në mënyrë që autoritetet shëndetësore të gjejnë shpejt kontaktet e afërta me ata që kanë konfirmuar të jenë infektuar me COVID-19.

Sa më shpejtë "detektivët e sëmundjes" të gjejnë këto kontakte të afërta, aq më shpejt mund të parandalojnë përhapjen e virusit.

Atëherë, çfarë kemi mësuar nga rritja e rasteve në Melburn? Një numër i konsiderueshëm i rasteve të reja është i lidhur me grumbullimet familjare.

Çfarë na tregon kjo? Duket se disa australianë nuk e vlerësojnë faktin që COVID-19 mund të jetë i rrezikshëm, madje edhe mes njerëzve që ata njohin mirë, duke përfshirë anëtarët e tyre të familjes.

Ndërsa kufizimet e COVID-19 janë lehtësuar dhe më shumë njerëz mund të takohen në shtëpi dhe vende si hotele dhe restorante, disa australianë po zgjedhin të mblidhen duke mos ruajtur distancën e duhur fizike. Kjo rrezikon anëtarët e tjerë të familjes, zakonisht të moshuarit, të cilët janë më në rrezik për t'ju nënshtruar efekteve të COVID-19, si dhe komunitetit më gjerë.

Prandaj, ju lutemi, nëse shkoni të takoni miq për një pije apo për të ngrënë diku ose në shtëpinë e dikujt, sigurohuni që ta bëni këtë në mënyrë të sigurt duke mbajtur distancën e duhur fizike.

Ju inkurajoj që të ndani këtë mesazh të rëndësishëm me anëtarët e familjes, miqtë, fqinjët dhe përmes komunitetit tuaj dhe rrjeteve të biznesit.

Rritja e rasteve në Viktoria gjithashtu na tregon se duhet të vazhdojmë të marrim mesazhet kryesore të praktikimit të distancës fizike dhe higjienës së duhur, dhe shkarkimit të aplikacionit COVIDSafe, në komunitetet ku anglishtja nuk është gjuha e parë që flitet ose lexohet.

Janë bërë shumë përpjekje për të siguruar që komunitetet tona multikulturore njoftohen vazhdimisht gjatë progresit të pandemisë së COVID-19.



Australian Government
Department of Health

Për shembull, informacioni kryesor për të ndihmuar individët, familjet dhe bizneset është përkthyer në 63 gjuhë.

Ka pasur më shumë se 900 000 vizita unike të faqes së internetit të *Informacionit për COVID-19 në gjuhën tuaj* që nga krijimi i saj.

Që nga fillimi i pandemisë, Departamenti i Komenuelthit të Punëve të Brendshme, përmes nëpunësve të tij ndërlidhës të komunitetit, ka qenë në kontakt me grupet e komunitetit multikulturor më shumë se 4 300 herë në shkallë kombëtare.

Përtej kësaj, është e qartë se disa njerëz mund të jenë të shqetësuar për testimin e COVID-19 kur nuk duhet të jenë. Kështu që, më lejoni ti siguroj njerëzit për këtë: testimi në një Klinikë të Frymëmarrjes i drejtuar nga një Mjek i Përgjithshëm (GP) dhe të financuar nga qeveria australiane, është absolutisht falas - dhe nuk ju nevojitet një kartë Medicare.

Kemi një rrugë të gjatë për të mposhtur COVID-19, dhe tani nuk është koha për pakujdesi. Ju lutemi vazhdoni të praktikoni distancën e duhur fizike dhe higjienën e duhur. Dhe ju lutemi, qëndroni në shtëpi nëse nuk jeni mirë.

Drejtoresha e punonjësve të Infermierisë dhe Mamisë së qeverisë australiane, Alison McMillan